



05



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

PËR FORMALIZIMIN NË BUJQËSI: MIRËFUNKSIONIMI I SKEMËS SË KOMPENSIMIT TË TVSH-së DHE NXITJA E INVESTIMEVE

Tiranë, Qershor 2016

Ky dokument pune është përgatitur nga ekspertët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve në kuadër të mbledhjes VI të Këshillit të Investimeve (29 qershor 2016), znj. Ermelinda Xhaja, eksperte për ekonominë dhe z. Elvis Zerva, ekspert ligjor, nën drejtimin e Drejtores së Sekretariatit, znj. Diana Leka (Angoni). Kontribut të veçantë në organizimin e debateve me subjektet e sektorit dhe përgatitjen e materialit ka dhënë ekspertja znj. Valbona Ylli. Mbështetje është ofruar nga znj. Elisa Lula, oficerë administrative dhe komunikimit pranë Sekretariatit në organizimin e takimeve me partnerë dhe redaktimin gjuhësor të materialit. Falenderojmë përfaqësuesit e institucioneve qendrore (DPT, MFE, MBZHR, DPD, Avokatin e Tatimpaguesit, etj.), subjektet private, shoqatat e biznesit (KASH, NBF, Shoqatën e Eksportuesve) dhe të fermereve (Kutalli, Sarandë), si edhe ekspertët e pavarur për bashkëpunimin në kuadrin e analizës dhe përgatitjes së materialit.

LISTA E SHKURTIMEVE

AKU	Agjencia Kombëtare e Ushqimit
AZhBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor e Rural
BE	Bashkimi Evropian
BERZh	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BT	Bashkia Tiranë
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DRB	Drejtoria Rajonale e Bujqësisë
FIAA	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri
GIZ	Agjencia Ndërkombëtare Gjermane për Zhvillim
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISSh	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
KASH	Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar
KM	Këshilli i Ministrave
MF	Ministria e Financave
MBZhRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave
MÇV	Ministria për Çështjet Vendore
MShMP	Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin
NIPT	Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
QKR	Qendra Kombëtare e Regjistrimit
ShBB	Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor
ShKK	Shoqëri e Kursim-Kreditit
SKI	Sekretariati i Këshillit të Investimeve
SNZhBR	Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillim Bujqësor e Rural
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
ZVRPP	Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
KONTEKSTI	6
GJETJET	11
1. Skema e Kompensimit të TVSH-së.....	11
2. Skemat mbështetëse - si incentive për formalizim dhe investime.....	16
3. Të tjera.....	13
REKOMANDIMET	19
1. Për një formë formalizimi për nxitjen e investimeve dhe rritjen e sigurisë ushqimore	19
2. Të tjera - Lehtësim të procesit të formalizimit.....	20
SHTOJCA 1	22
SHTOJCA 2	24

HYRJE

Bujqësia përbën një nga sektorët kryesorë të ekonomisë shqiptare duke kontribuar gjatë periudhës 1996 – 2014 në mesatarisht 25%¹ të PBB si edhe duke punësuar rreth gjysmën e fuqisë punëtore. Eksportet e produkteve bujqësore kryesuar nga bimët medicinale, aromatike e etero-vajore, perimet dhe frutat kanë njohur rritje gjatë 2014 dhe 2015². Aktualisht, sektori është përfshirë në prioritetet strategjike të qeverisë për zhvillim duke i ofruar edhe lehtësira procedurale sipas Ligjit “Për Investimet Strategjike”³. Ndërkohë, bujqësia vazhdon të mbetet një nga sektorët më informalë të ekonomisë, ku informaliteti vihet re në nivele të ndryshme në të gjitha hallkat e zinxhirit të prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore e blegtorale. Ky dokument përpiket të evidentojë formalizimin e sektorit në kuadër të iniciativave të Qeverisë

për pajisjen me NIPT të fermerit, skemën e kompensimit me 20% të TVSH-së për prodhuesit bujqësorë dhe mbështetjes financiare të sektorit. Fokusi i analizës lidhet kryesisht me rolin dhe ndikimin që kanë luajtur realisht këto masa në formalizimin e aktorëve, strukturimin e tregut, nxitjen për investime dhe sigurinë ushqimore. Në këtë kontekst, analiza nuk pretendon të trajtojë në mënyrë shteruese të gjitha problematikat e sektorit, por synon të sjellë në vëmendje disa fakte dhe të nxisë debatin konstruktiv midis aktorëve të përfshirë, fermerë, biznese, institucione dhe donatorë lidhur me masat e nevojshme për një formalizim të mëtejshëm të të gjithë hallkave të sektorit. Një model i analizës së aktorëve të nënsektorit të perimeve sillet në vëmendje në Shtojcën 2.

Përgatitja e këtij dokumenti është realizuar nga SKI, pas analizës së një sërë dokumentash ligjorë dhe politikë të qeverisë mbi bujqësinë. Për më tepër, janë zhvilluar rreth 25 takime (maj-qershor) me aktorë të ndryshëm publik e privatë të sektorit duke sjellë këndvështrimin e grupeve të ndryshme të interesit⁴ dhe janë organizuar dy takime me grupe të fokusuar, një me fermerë dhe grumbullues të perimeve (me 22 pjesëmarrës) në Samaticë të Beratit dhe një me ekspertë të bujqësisë e tatimeve (12 pjesëmarrës) në Tiranë. Në këtë kuadër, SKI ka qenë edhe pjesë e diskutimeve mbi formalizimin dhe problemet në bujqësi organizuar nga KASH, me pjesëmarrjen e rreth 25 fermerëve dhe shoqatave të tyre në Sarandë, në prani të Ministrit të Bujqësisë, përfaqësuesve të strukturave të bujqësisë dhe tatimeve.


¹ Llogaritë Kombëtare Vjetore, Metoda e Prodhimit (1996-2014), INSTAT
² Përkatësisht me 9% dhe 44% për periudhën janar – shtator, 2014 -2015, DPD
³ Në bazë të Nenit 8 paragrafi 3 pika ç) të Ligjit Nr. 55/2015 “ Për Investimet Strategjike” bujqësia konsiderohet sektor strategjik: “ç) Për sektorët “Bujqësi (ndërtimi i modelit të “Fermës së madhe bujqësore”) dhe peshkim” investimi të jetë: » i barabartë ose më i madh se 3 000 000 (tre milionë) euro, dhe që, në të njëjtën kohë, krijon, minimalisht, 50 vende të reja pune, për investitorët/projektet që do të përfitojnë statusin “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar”; » i barabartë ose më i madh se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro, për investitorët/projektet që do të përfitojnë statusin “Investim /investitor strategjik, procedurë e veçantë”.

⁴ Në takime janë përfshirë institucione si MShMP, MÇV, MBZhRAU, AKU, MF, DPT, AZhBR, BT, DRB në Tiranë dhe Lushnje, INSTAT, donatorë, fermerë, grumbullues dhe eksportues të sektorit.

KONTEKSTI

Një sërë iniciativash të Qeverisë Shqiptare dhe donatorëve të huaj si BERZH, Bashkimi Evropian (BE), USAID, DANIDA, etj., janë ndërmarrë në mbështetje të investimeve në sektor për të nxitur me tej potencialin e tij prodhues dhe përpunues, si për tregun vendas dhe atë ndërkombëtar. Megjithatë bilanci tregtar në zërin ushqime, pije dhe

duhan mbetet ende negativ (raporti eksport - import respektivisht është përafërsisht 1:5⁵), edhe pse eksportet bujqësore kanë njohur një rritje të vazhdueshme. Sipas të dhënave nga INSTAT, eksportet vendase janë rritur ndjeshëm për vitin 2015 kundrejt 2014. Konkretisht, me 46% rritje në vlerë në kategoritë “Pemë, fruta dhe perime”, dhe 26% rritje në vlerë në totalin “Ushqime, pije, duhan”.




Burimi: INSTAT, Llogaria Kombëtare Vjetore (Metoda e Prodhimit), Qershor 2016

5 INSTAT, Tregtia e Jashtme sipas Produkteve 1993 - 2015
6 Eksportet e produkteve bujqësore, INSTAT

PËR FORMALIZIMIN NË BUJQËSI:
MIRËFUNKSIONIMI I SKEMËS
SË KOMPENSIMIT TË TVSH-SË
DHE NXITJA E INVESTIMEVE

Figura 2. Eksportet për Ushqime, Pije, Duhan 2011 – 2015 (Mil ALL)



Burimi: INSTAT, Tregtia e Jashtme sipas Produkteve, 1993- 2015

Megjithë sinjalet pozitive nga eksportet dhe interesit për të shtrirë investimet në sektor, bujqësia shqiptare vazhdon të vuajë nga një produktivitet shumë i ulët, si pasojë e operimit në ferma me madhësi shumë të vogël, fragmentimit të tejskajshëm të tokës që thellohet më tej, mungesës së përdorimit të teknologjive bashkëkohore dhe investimeve në nivele të kufizuara. Referuar Bankës së Shqipërisë⁷ (BSh), kredia në bujqësi dhe peshkim nga viti 2011 e në vazhdim ka përbërë vetëm 2% të totalit të kredive, nivel që tregon vlerën e ulët të investimeve në sektor. Gjithashtu, të dhënat e DPD, flasin për një rënie të lehtë me 2% të importit të makinerive bujqësore për vitin 2015 kundrejt vitit 2014.

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (SNZhBR) 2014 – 2020⁸ ka përcaktuar kuadrin strategjik për trajtimin e sfidave me të cilat përballet sektori i bujqësisë dhe agro-përpunimit si dhe ka orientuar zhvillimin e zonave

rurale në një mënyrë të qëndrueshme ekonomike, mjedisore dhe sociale. Strategjia e trajton ndër të tjera nxitjen e formalizimit të bujqësisë nëpërmjet skemave mbështetëse dhe rritjes së sigurisë ushqimore përmes gjurmueshmërisë së produkteve bujqësore.

Qeveria shqiptare ka një program të dedikuar në buxhetin e shtetit për skemat mbështetëse në bujqësi që zbatohet nga MBZhRAU nëpërmjet AZHBR-së. Fondi i skemave mbështetëse për vitin 2016 është përafërsisht në shumën 2 miliardë ALL⁹ me një rritje prej 7% kundrejt vitit 2015. AZHBR ofron mbështetje sipas hartës bujqësore në 19 skema për prodhimin bujqësor, blegtoral dhe agro-përpunimin. Këto skema janë të orientuara në nxitjen e investimeve, përmirësimin e teknologjisë, prodhimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, rritjen e cilësisë e standardeve të produkteve si dhe mbështetje për formalizim dhe bashkëpunim bujqësor¹⁰. Kriteret për aplikim janë pothuajse të njëjta, ku kërkesa për të qenë i pajisur me NIPT është e domosdoshme në të gjitha skemat. Skemat e investimeve dhe ato të mbështetjes për pagesat e interesave të kredisë kanë edhe disa kërkesa më specifike si lejet e ndërtimit, kontrata me bankat, ofertat për kryerjen e investimit, regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dëshmia e penalitetit, etj. Krahas skemave mbështetëse të Qeverisë, edhe donatorët ofrojnë programe mbështetëse për sektorin si programi SARED (Qeveria Daneze dhe ajo Gjermane (GIZ)), programi IPARD i BE-së që pritet të fillojë në fund të vitit 2016. Por, edhe ske-

9 Buxheti i Shtetit 2016, MF, www.financa.gov.al

10 Kriteret bazë për sektorët që do të mbështeten përcaktohen nga VKM Nr. 91 Datë 10.02.2016 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2016”, ndërsa procedurat dhe mënyra e administrimit përcaktohen në bazë të Udhëzimit të përbashkët të MBZhRAU dhe MF Nr. 2 Datë 17.02.2016.

7 Banka e Shqipërisë - Raporti tre mujor i politikës monetare, 2016/II

8 Miratuar nga KM në Tetor 2014

mat e donatorëve si bazë të kriterëve për aplikim ndër të tjera kanë edhe kërkesat për formalizim të përfituesve. Skema e AZHBR-së, IPARD Like si dhe SARED, shërbejnë edhe për një edukim dhe ndërgjegjësim të fermerëve për procedurat e aplikimit për të qenë në një moment të dytë të përgatitur për kërkesat më të detajuara dhe strikte të fondeve të BE-së përmes programit IPARD. Në vitin 2008, në kuadër të formalizimit të bujqësisë, filloi regjistrimi i fermerëve dhe pajisja e tyre me “*Kartën e Fermerit*”. Ky proces synonte identifikimin e fermerit në kryerjen e aktivitetit prodhues bujqësor e blegtoral, duke i shërbyer atij edhe për përfitimin nga skemat mbështetëse. Sidoqoftë, për shkak të shumë arsyeve të tjera pavarësisht pajisjes me kartë fermeri, përfitimet nga skemat mbështetëse ishin të kufizuara, gjë që solli dhe zbehjen e interesit të shfaqur fillimisht për pajisjen me kartë, duke bërë kështu që numri i fermerëve të pajisur me kartë sikurse është konfirmuar edhe nga MBZhRAU të jetë rreth 33.000 fermerë.

Formalizimi në bujqësi është parë i lidhur ngushtë edhe me kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore e shëndetësore. *Ligji nr. 153/2014 “Për Faljen e Kamatëvonesave dhe Gjohave për Kontributet e Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore të Papaguara nga Personat e Vetëpunësuar në Bujqësi”* përbën një përpjekje tjetër në funksion të konsolidimit të ekonomive bujqësore duke synuar regjistrimin dhe formalizimin e një mase të konsiderueshme personash të vetëpunësuar (përfshirë dhe emigrantët)¹¹. Ndërkohë sipas statistikave të ISSh numri i të vetëpunësuarve në bujqësi të cilët deklarojnë

11 Me anë të këtij ligji u falën kamatëvonesat e kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të papaguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi, të cilët do të arkëtonin kontributet e paderdhura brenda datës 31.12.2014.

kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore është 89.527 për vitin 2015 nga 127.728 të raportuar për vitin 2014.

Grumbullimi i të dhënave dhe përpilimi i tyre (nga viti 2010 e aktualisht) për sektorin e bujqësisë ka ndryshuar përgjegjësinë institucionale nga MBZhRAU në INSTAT dhe aktualisht sistemi është në diskutim për t’u rikthyer sërish si përgjegjësi e MBZhRAU. Grumbullimi e përpunimi i të dhënave të sakta për sektorin përbën një element thelbësor për të analizuar prodhimin bujqësor e blegtoral, njësitë që merren me aktivitetet prodhuese sipas nënsektorëve apo në nënsektorë miks, përpunimin e produkteve, volumet e eksporteve, volumet e importeve, vlerat monetare që gjenerohen nga sektori, etj. Të dhëna të tilla janë bazë për analiza më të detajuara dhe për të projektuar politika në mbështetje të sektorit bujqësor. Të dhënat administrative të INSTAT që si burim kanë MBZhRAU paraqesin 352.315 ferma në të gjithë territorin e vendit gjatë vitit 2014. Megjithatë, nga takimet me ekspertë të bujqësisë këto statistika vihen në dyshim, duke patur në konsideratë se kriteri kryesor i identifikimit të fermave dhe fermerëve është parimi për ndarjen e tokës bujqësore sipas Ligjit 7501. Problematikat në lidhje me statistikat në sektorin bujqësor janë evidentuar edhe nga Progres Raporti i Komisionit Evropian (2015), sipas të cilit rekomandohet që *vendi duhet të përmirësojë statistikat në sektorin bujqësor*.

Ligji nr. 38/2012 “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor” (SHBB) tenton të nxisë formalizimin dhe bashkëpunimin e fermerëve shqiptarë. Sipas këtij ligji SHBB, të cilat krijohen dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me përcaktimet e këtij ligji janë subjekt i lehtësive fiskale dhe skemave mbështetëse. Aktualisht rezulton se në Qendrën Kombëtare të Biznesit janë regjistruar

vetëm 58 SHBB. Megjithatë, ka një skepticizëm nga të intervistuarit mbi aktivitetin e tyre duke aluduar për një numër shumë më të vogël që funksionojnë në realitet si të tilla. Në praktikë ka një konfuzion nga vetë SHBB mbi avantazhet që ato kanë, për sa kohë që në aktet nënligjore nuk janë parashikuar lehtësira fiskale apo subvencione të dedikuara ekskluzivisht për to.

Shoqëritë e Kursim-Kreditit (SHKK) dhe Unionet kanë si funksion mbledhjen e depozitave dhe dhënien e kredive favorizuese për kontribuesit anëtarë të tyre veçanërisht në zonat rurale. Numri i SHKK ka vijuar të reduktohet, si rezultat i procesit të likuidimit të disa prej tyre. Aktualisht operojnë 113 SHKK dhe 2 Unione të tyre. Pësha e kredive të ofruara nga ky rrjet përbën rreth 0,80% të kredive të sistemit bankar në RSh¹². SHKK dhe Unionet konsiderohen si alternativë për *akses në kreditim* lidhur me investime në bujqësi dhe ndërgjegjësim për formalizim, ndonëse vlera e tyre e kreditimit për individin mbetet në vlera të vogla e të pa përfillshme për investime të konsiderueshme në bujqësi.

Në kuadër të paketës fiskale në fushën e bujqësisë dhe përpjekjeve për formalizimin e zinxhirit të prodhimit dhe tregtimit të prodhimeve bujqësore, Ministria e Financave ka miratuar Udhëzimin nr. 19 datë 03.11.2014 “*Për Zbatimin e Regjimit të Veçantë të Skemës së Kompensimit të Prodhuesve Bujqësorë për Qëllime të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar*” (Udhëzimi Nr. 19). Skema u përgatit në bazë dhe për zbatim të Ligjit të ri nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “*Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar*”¹³.

12 Burimi: Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes 2014 i Bankës së Shqipërisë


13 Vazhdimisht qeveritë kanë bërë përpjekje të vazhdueshme për t’i ardhur në ndihmë sektorit të bujqësisë, ku një ndër to është heqja apo rimbursimi i TVSH-së së inputeve bujqësore. Kështu me Ligjin Nr. 111/2013 “Për Disa Shtesa Në Ligjin Nr. 7928, Datë 27.4.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, të

Skema u konceptua për të mundësuar kompensimin e TVSH-së për fermerët si një stimul i drejtpërdrejtë për ta. Qëllimi i saj është të mbulojë TVSH-në e paguar nga fermerët për blerjen e inputeve dhe shërbimeve për prodhimin e produkteve bujqësore. Skema parashikon kompensimin e fermerëve nëpërmjet përgatitjes së autofaturës nga grumbulluesit. Udhëzimi nr. 19 datë 03.11.2014 në një periudhë të shkurtër, ka qenë objekt i ndryshimeve tre herë nga Ministria e Financave (Udhëzimi Nr. 23 datë 07.09.2015; Udhëzimi Nr. 26 datë 26.10.2015 dhe Udhëzimi Nr. 10 datë 03.05.2016). Me anë të këtyre ndryshimeve është synuar të zgjidheshin në mënyrë të shpejtë ato paqartësi të cilat lindnin në praktikë. Përveç të tjerave u kalua gradualisht nga mundësia e kryerjes së transaksioneve (pagesë) grumbullues-fermerë vetëm nëpërmjet bankës, drejt mënyrave alternative sikurse është pagesave nëpërmjet shërbimeve të Postës Shqiptare dhe pagesave në dorë (cash) duke adresuar shqetësimet e fermerëve dhe grumbulluesve. Në Shtojcën 1 paraqitet në mënyrë të përmbledhur funksionimi i skemës dhe subjektet e saj.

Sipas të dhënave më të fundit të DPT, numri i fermerëve të regjistruar deri në prill 2016 është 29.919 si në Grafik 3 më poshtë.

ndryshuar parashikoheshin si furnizime të përjashtuara blerja e një sërë inputeve bujqësore dhe blegtorale nga ana e fermerit. Por, në mungesë të një vizioni të qartë mbi këto incentiva, me Ligjin Nr.142/2013 i miratuar në datën 02.05.2013, vetëm disa ditë nga miratimi i Ligjit Nr. 111/2013, ky i fundit u shfuqizua. Në Ligjin e ri për TVSH Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 inputet bujqësore nuk u përjashtuan nga TVSH, por thjesht ndryshoi skema e kompensimit e cila u mbështet në Udhëzimin Nr. 19.

Figura 3. Të regjistruar me NIPT fermeri sipas Drejtorive Rajonale Tatimore



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Sipas raportimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka patur një dinamikë në rritje të blerjeve me NIPT fermeri që është në linjë me rritjen e numrit të regjistrimeve. Megjithatë është e vështirë për të gjykuar mbi efektivitetin e skemës në raportimet e blerjeve duke

qenë se periudha kohore është shumë e limituar në 18 muaj dhe të dhënat janë edhe nën ndikimin e sezonalitetit të prodhimit në bujqësi. Nga momenti i aplikimit të skemës deri më tani, sipas DPT vlere e kompensimit të TVSH-së llogaritet në rreth 627 milion ALL.

GJETJET

Të gjithë aktorët e kontaktuar konfirmojnë nevojën për reformë të thellë në bujqësi, të shtrihet në të gjithë hallkat, pasi në të kundërt, dëmtohet konkurrenca e ndershme dhe vihen në diskutim standardet lidhur me sigurinë ushqimore. Një këndvështrim tjetër është edhe ai përmes të cilit formalizimi i sektorit lidhet me fuqizimin e gjurmueshmërisë duke garantuar kështu sigurinë ushqimore tek konsumatori final. Sipas këtij këndvështrimi, garantimi i sigurisë ushqimore në standardet e BE-së do të imponojë formalizimin e të gjithë zinxhirit, për rrjedhojë dhe rritje të konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare në tregje rajonale dhe ndërkombëtare duke nxitur në këtë frymë edhe investimet në bujqësi.

1. SKEMA E KOMPENSIMIT TË TVSH-SË

a. Aspektet pozitive të skemës

01. Në dallim nga skemat e mëparshme para vitit 2014, një ndër masat më të rëndësishme të ndërmarra në udhëzim është njohja për qëllime kompensimi të TVSH-së së produkteve bujqësore me 20% nga 6% që ishte më parë për prodhuesit bujqësorë dhe grumbulluesit, duke mirëpërcaktuar në mënyrë të detajuar mënyrën e funksionimit të skemës përkatëse dhe krijuar njëtrajtshmëri në aplikimin e TVSH-së. Udhëzimi i ri shikohet si një mundësi për të krijuar tregje të reja, formale dhe të sigurta për fermerët nëpërmjet pajisjes me NIPT dhe një kompensimi në masën 20%. Skemat e mëparshme kishin si qëllim të siguronin një mbështetje për fermerët duke parashikuar vetëm 6% kompensim, por nga ana tjetër krijuan edhe kosto shtesë për grumbulluesit të cilët e kishin të pa mundur të shkarkonin (përveçse tek konsumatori final) diferencën prej 14% midis TVSH-së në blerje dhe asaj në shitje të produktit.

01. Norma e kompensimit prej 20% që parashikon skema, vlerësohet se barazon dhe neutralizon TVSH-në e pagueshme për grumbulluesin dhe përpunuesin duke inkurajuar këtë të fundit të lëshojë futurë me TVSH (duke e kredituar atë); rrit interesin e fermerit për t'u pajisur me NIPT për qëllime të kësaj skeme pranë Drejtorive Rajonale Tatimore, rrit interesin e tij për të marrë auto-faturën me TVSH nga shitësi (grumbulluesit, duke mirëpërcaktuar në mënyrë të detajuar mënyrën e funksionimit të skemës përkatëse dhe krijuar njëtrajtshmëri në aplikimin e TVSH-së. Udhëzimi i ri shikohet si një mundësi për të krijuar tregje të reja, formale dhe të sigurta për fermerët nëpërmjet pajisjes me NIPT dhe një kompensimi në masën 20%. Skemat e mëparshme kishin si qëllim të siguronin një mbështetje për fermerët duke parashikuar vetëm 6% kompensim, por nga ana tjetër krijuan edhe kosto shtesë për grumbulluesit të cilët e kishin të pa mundur të shkarkonin (përveçse tek konsumatori final) diferencën prej 14% midis TVSH-së në blerje dhe asaj në shitje të produktit.

bulluesi/përpunuesi) sepse mundëson shitjen e produkteve tek këta të fundit me një çmim më të lartë (20% më shumë), si dhe bën praktike marrjen nga fermeri dhe monitorimin nga strukturat përgjegjëse të skemave mbështetëse në bujqësi, të cilat kanë si parakusht pajisjen me NIPT. Për më tepër, përpunuesi i produkteve bujqësore, duke qenë se nuk merrte fature tatimore nga fermeri ishte i interesuar të blinte lëndë të parë importi duke kredituar 20% të TVSH-së në import. Fakti që sot përpunuesi mund ta autofaturojë TVSH-në, produkti bujqësor shqiptar mund të konkurrojë produktin e importit duke qenë se formalizohet lënda e parë.

02. Skema ka lehtësuar eksportuesit. Kombinimi i kësaj mase edhe me disa lehtësira procedurale si p.sh. klasifikimi me risk zero i grumbulluesve eksportues sipas kriterëve të përcaktuara me VKM Nr. 953 datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”; përjashtimi nga TVSH-ja në importin e makinerive bujqësore¹⁴ dhe për të gjithë kafshët/shpendët, etj., apo shërbimi doganor 24 orë për eksportet e prodhimeve bujqësore dhe kalimi i produkteve bujqësore në “kanalin jeshil” pa kyer asnjë kontroll doganor ka krijuar një klimë pozitive për bizneset në sektorin e bujqësisë. Kështu për vitin 2015 është verifikuar një rritje e eksporteve¹⁵ të prodhimeve bujqësore në pemë, perime dhe fruta prej 46 % në vlerë.

14 Sipas përcaktimeve të Nenit 56 paragrafi 41 i Ligjit Nr.92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSh” (i ndryshuar) dhe Nenit 8 të VKM Nr. 953 datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr.92/2014, “Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”

15 Grumbulluesit eksportues nuk janë të përjashtuar nga përfitimet e kësaj Skeme duke përfituar kështu jo vetëm nga mundësia për të kompensuar TVSH-në por edhe nga regjimi i

03. Pajisja me NIPT për qëllime të këtij udhëzimi nuk e ngarkon fermerin me ndonjë detyrim tatimor apo përgjegjësi fiskale, por krijon mundësi nga njëra anë për fermerët për të siguruar treg dhe shitur me një çmim më të lartë prodhimet e tyre bujqësore në subjekte formale dhe të identifikuar, si edhe nga ana tjetër forcon rolin e grumbulluesve të prodhimeve bujqësore si ndërmjetës midis fermerëve dhe eksportuesve/tregtarëve duke mundësuar/krijuar tregje të reja dhe të sigurta për prodhimet bujqësore të fermerëve.

04. Lejimi i kryerjes së shitjeve me para në dorë deri në vlerën 30.000 ALL, (mjaft i mirëpritur nga fermerët ndonëse ende me diskutime lidhur me limitin e tij në praktikë), **rimbursimi automatik i TVSH-së brenda 30 ditësh**¹⁶ për eksportuesit e prodhimeve bujqësore që klasifikohen si subjekte me risk zero dhe mundësia për të përgatitur vetë **fatura kompjuterike elektronike**, përbëjnë përmirësime të skemës për ta bërë gjithmonë e më tepër tërheqëse për palët e përfshira.

b. Problematikat e konstatuara nga zbatimi në praktikë i skemës

01. Informacion dhe ndërgjegjësim i pamjaftueshëm i fermerëve mbi regjistrimin me NIPT-redukton mundësitë për efektivitetin e skemës
Fushata e nisur në fund të vitit 2014 për regjistrimin dhe pajisjen e fermerëve me NIPT u shoqërua me një numër të lartë regjistrimesh në fund të 2014 dhe muajt e parë të

eksporteve në RSh sipas të cilit TVSH në eksport është 0.

16 Shuma e paguar fermerit prej 20% për normën e kompensimit për blerjen e produkteve të tij, por edhe çdo TVSH e paguar për shpenzimet e përgjithshme që një eksportues kryen në kuadër të veprimtarisë së tij, i rimburohet brenda 30 ditëve. Kështu ky biznes ka mundësi të investojë e të zgjerojë kapacitetet e veta përpunuese dhe eksportuese.

2015. Nga intervistat me vetë fermerët, regjistrimi me NIPT deri më sot mund të thuhet se ka ardhur kryesisht si pasojë e “presionit” dhe rolit të grumbulluesit dhe përpunuesit sesa reflektim e ndërgjegjësim i fermerit mbi përfitimet nga skema e TVSH-s. Një arsye tjetër e regjistrimeve të kryera ka qenë dhe vendosja si kriter aplikimi dhe përfitimi në të gjitha skemat mbështetëse të bujqësisë si të Qeverisë Shqiptare nëpërmjet AZHBR edhe të donatorëve.

Në terren vihet re një mungesë informimi profesional, ose edhe disinformim për fermerët. Është krijuar ideja se pajisja me NIPT shoqërohet edhe me detyrimin për të kryer deklaram për qëllime tatimore, në një kohë që vetë udhëzimi e sqaron në mënyrë të qartë se fermerët nuk e kanë këtë barrë administrative. Pavarësisht nga ky fakt, pajisja me NIPT përbën në thelb krijimin e marrëdhënieve të fermerit me organet tatimore, gjë e cila kërkon edhe një nivel të caktuar të të kuptuarit të vetë nocionit dhe funksionit të individit si një tatim-pagues.

Duke patur parasysh se 76%¹⁷ e popullsisë rurale mbi 14 vjeç kanë arsimim deri në klasën e 10-të, rezulton se niveli i edukimit të fermerëve është një faktor që çon domosdoshmërisht në nevojën për ndërgjegjësim e informim të tyre mbi pajisjen me NIPT, funksionin e NIPT-it në marrëdhëniet me organet tatimore, me aktorët e tjerë të sektorit, si dhe përfshirjen në skemat e TVSH-së. Shumica e fermerëve¹⁸ të kontaktuar nga SKI pranojnë se nuk kanë marrë këshillim mbi mënyrën e funksionimit të skemës së kompensimit dhe mbi kërkesat procedurale të regjistrimit

17 INSTAT, Census i Popullsisë 2011

18 Ky fakt është konfirmuar nga fermerët dhe shoqatat

për qëllime të kësaj skeme apo të pajisjes me NIPT¹⁹. Ata e perceptojnë si shumë të vështirë pajisjen me NIPT për shkak të disa kërkesave procedurale sikurse është p.sh. marrja e vërtetimeve pranë DRB dhe më pas regjistrimi pranë DRT të cilat në disa raste janë larg qendrave të tyre të banimit. Fermerët shprehin skepticism mbi përfitimet që mund t’ju sjellë pajisja me NIPT. Ata kanë frikë të regjistrohen në drejtoritë rajonale tatimore duke mos patur besim se regjistrimi me NIPT nuk do të pasohet me detyrime tatimore dhe kontrole, ndonëse skema garanton barrë administrative dhe fiskale “0” për fermerët e pajisur me NIPT dhe të cilët kryejnë xhiro vjetore deri në 5 milion ALL.

02. Ndonëse udhëzimi është i qartë akoma ka ngatërresa mbi regjistrimin me NIPT – Kartë fermeri – Regjistër ferme – Karta e identitetit

Në kushtet aktuale fermeri ka në dispozicion kartën e identitetit (si çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë), kartën e fermerit, si dhe NIPT-in duke krijuar ngatërresa tek fermeri mbi qëllimin e secilit prej tyre. Ashtu sikurse raportohet nga grumbulluesit e produkteve (të cilët përgatisin autofaturat) autofaturat përgatiten si në adresë të mbajtësit të numrit të NIPT-it, po ashtu edhe në adresë të mbajtësit të kartës së fermerit, apo zotëruesit të kartës së identitetit. Nga një grumbullues perimesh informohemi se ai grumbullon produkte nga rreth 120 fermerë të cilët janë të pajisur me NIPT, si dhe nga rreth 500 fermerë të cilët nuk janë të pajisur me NIPT, por duke pasqyruar numrin e kartës së tyre të identitetit.

përfaqësuese të tyre përfshirë dhe KASH në takimet e zhvilluara në Samaticë-Komuna Kutalli dhe në Sarandë.

19 Në raste të tjera p.sh. Lushnjë, procesi i informimit, ndërgjegjësimit dhe informimit të fermerëve nga strukturat përkatëse (DRB e DRT) ka qenë më i shpejtë dhe më i koordinuar.

Një subjekt që grumbullon erëza, bimë medicinale dhe aromatike nga rreth 300-400 fermerë, përgatit autofatura për vetëm 15% të tyre duke pasqyruar NIPT, ndërsa për pjesën tjetër të fermerëve autofaturat përgatiten duke pasqyruar numrin e kartës së identitetit.

03. Perceptime të ndryshme në lidhje me përfituesit e skemës

Sipas pjesës më të madhe të grumbulluesve dhe përpunuesve skema është funksionale në praktikë, ndërsa sipas fermerëve pretendohet se skema mund të jetë funksionale, por vetëm për grumbulluesit dhe përpunuesit dhe akoma jo për fermerët të cilët i shesin produktet e tyre me të njëjtin çmim sikurse edhe përpara zbatimit të kësaj skeme.

04. Grumbulluesit, përpunuesit dhe tregtarët nën-vizojnë mungesën e informacionit paraprak mbi aspektet procedurale me pasoja financiare dhe rritje të mosbesimit mbi iniciativat.

Pavarësisht se Udhëzimi nr. 19 parashi-kon procedura të thjeshta administrative mbi mënyrën e funksionimit dhe zbatimit të skemës së kompensimit, konstatohet se edhe disa nga grumbulluesit, përpunuesit dhe tregtuesit kanë informacion të mangët lidhur me disa aspekte procedurale, të cilat janë të domosdoshme për funksionimin e skemës dhe për zbatimin e saj në praktikë. Konkretisht, bizneset bujqësore në Sarandë pretendojnë se nuk ka patur asnjë lloj informacioni paraprak nga drejtoritë e bujqësisë apo drejtoria rajonale tatimore lidhur me dokumentat që duhet të disponojnë për të aplikuar për kompensimin e TVSH-së.

Sipas tyre në mungesë të sqarimeve, informacioneve dhe këshillimit nga ana e këtyre

strukturave²⁰, dhe në kushtet e një informacioni jo të qartë, kanë blerë prodhime bujqësore nëpërmjet autofaturimit nga fermerët e pajisur me NIPT, por në mungesë të akt-marrëveshjeve përkatëse me fermerët sikurse përcaktohet qartë nga udhëzimi²¹. Në mungesë të këtij dokumentacioni, aplikimet e tyre pranë DRT Sarandë për kompensimin e TVSH-së nuk janë marrë në konsideratë, duke pësuar kështu humbje financiare dhe duke u bërë subjekt i penalteteve. Sipas tyre në themel të kësaj problematike nuk qëndron skema në vetvete dhe mënyra e konceptimit të saj, por mungesa e theksuar e informacionit dhe paqartësia e strukturave përgjegjëse në përcjelljen dhe zbatimin e përcaktimeve të kësaj skeme në praktikë. Në këto kushte tek këto biznese është krijuar skepticizëm mbi qëllimin e skemës, nga mundësi përfitimi, në mjet penalizimi nga ana e administratës.

05. Ndonëse ende shpejt për një vlerësim, ka reagime mbi limitin e ulët të transaksioneve me para në dorë pasi mund të krijojë "artificalitetin" për t'u përshatur skemës.

Të gjithë aktorët i kanë mirëpritur ndryshimet e bëra në udhëzimin Nr. 19, por sërish mbetet shqetësim për të dyja palët (si fermerë dhe grumbullues, përpunues, tregtues), vlera e ulët prej 30.000 ALL si tavan për lejimin e këtyre transaksioneve për efekt të zbatimit të skemës së kompensimit. Kjo lidhet kryesisht me nivelin e aksesit të kufizuar në shërbimet bankare për të dyja palët që ushtrojnë veprimtarinë e

²⁰ Nga takimet del se në Lushnje ka një koordinim më të mirë të strukturave në lidhje me dhënien e informacionit për fermerët;

²¹ Kjo problematikë lidhet me periudhën shtator 2014 deri në fillim të 2015.

tyre ekonomike në zona të vështira rurale, ndërsa marrja e këtyre shërbimeve pranë qendrave të qyteteve është me kosto të lartë. Kjo ka krijuar vështirësi si për shitësit e produkteve ashtu edhe për blerësit e tyre, vështirësi të cilat në disa raste janë zgjidhur nëpërmjet artificave praktike p.sh. duke copëtuar transaksionet reale të shit-blerjes në transaksione me vlerë prej 30.000 ALL, ose duke kryer transaksione me përdorimin e NIPT-it të njëri-tjetrit.

06. Ekzistenca e tregjeve paralele informale të shumicës - konkurrencë e pandershme për grumbulluesit e licencuar

Sipas grumbulluesve, veçanërisht në zonat tradicionale bujqësore (Lushnje dhe Fier) vihet re fenomeni i tregjeve informale të shumicës, ku vetë fermerët në kërkim të një çmimi më të lartë për prodhimet e tyre bujqësore, shesin pa asnjë lloj dokumentacioni duke mos i dërguar prodhimet e tyre pranë pikave të licencuara të grumbullimit. Referuar anketës së FIAA dhe Unionit Shqiptar Kursim - Kredit në 2014²², rreth 50% e fermerëve e shesin direkt produktin në tregje ose në rrugë. Sipas perceptimit të aktorëve të rëndësishëm të fushës, përfshirë fermerë, grumbullues, përpunues apo dhe struktura shtetërore si DRB dhe bashki, modeli aktual i tregut dhe monitorimi i tij si nga pikëpamja e sigurisë ushqimore ashtu edhe nga pikëpamja e çmimeve nuk funksionon. Sipas këtyre grumbulluesve një formë tjetër informale është edhe blerja e produkteve bujqësore nga importuesit (kryesisht kosovarë dhe maqedonas) dre-

²² FIAA, ASC Union "Albanian Agriculture seen from the everyday farming: a Survey on Albanian farmers and EU exports" support by EU, July 2014

jtpërdrejtë tek fermat bujqësore. Këta importues janë të gatshëm të paguajnë një çmim edhe më të lartë se ai i grumbulluesve shqiptarë, ose paguajnë të njëjtin çmim sikurse grumbulluesit shqiptarë, por duke mos kërkuar nga fermerët seleksionimin paraprak sipas cilësisë të produkteve bujqësore. Këto pretendime të grumbulluesve janë diskutuar në takimet e SKI edhe me fermerët. Këta të fundit e pranojnë këtë fakt, por sipas tyre kjo situatë është e kushtëzuar nga çmimet e pafavorshme të vendosura nga grumbulluesit e mëdhenj, çmime të cilat sipas tyre në shumë raste janë abuzive dhe nën koston reale të prodhimeve të tyre bujqësore.

Sipas fermerëve prodhimet bujqësore vendase kanë një kosto më të lartë, në krahasim me prodhimet bujqësore në vendet e tjera të rajonit, për shkak se në vendet e rajonit aplikohen çmime më të ulëta të inputeve bujqësore²³ dhe niveli i subvencioneve të drejtpërdrejta për fermerët është më i lartë. Ka një perceptim të përgjithshëm në takimet e zhvilluara se të qenit informal të lehtë jashtë "radarit" të kontrollit të institucioneve shtetërore duke qënë se je i paidentifikuar. Problematikë e vazhdueshme mbeten pikat e grumbullimit dhe përpunimit të qumështit dhe mishit, pasi qendrat e shumta informale të tyre shmangin edhe standardet e kërkuara nga ligji duke rritur pasigurinë ushqimore për konsumatorin. Gjithashtu ekzistenca e këtyre tregjeve informale paralele ka lejuar fermerët t'i shmangen formalizimit dhe regjistrimit me NIPT.

²³ Kanë TVSH-në më të ulët se Shqipëria për inputet bujqësore, p.sh. Kosova 0%, Maqedonia 5%, Serbia 8%, Mali Zi 7%.

2. SKEMAT MBËSHTETËSE - SI INCENTIVA PËR FORMALIZIM DHE INVESTIME

a. Ndonëse në rritje në dy vitet e fundit - buxheti i limituar

Fondi i skemave mbështetëse të Qeverisë Shqiptare për bujqësinë edhe pse ka qenë në rritje në dy vitet e fundit (me 50% në 2015 dhe 7% në 2016) sërish mbetet shumë i vogël (rreth 15 milion EUR për 2016) dhe disa herë më i ulët se ai në vendet fqinje (Maqedonia 150 milion EUR, Kosova rreth 60 milion EUR) duke e bërë bujqësinë shqiptare më pak konkurruese në rajon. Në këto kushte mundësitë për të përfituar nga skema edhe pse fermeri mund të ketë arritur të plotësojë të gjitha kriteret reduktohen gjithmonë e më shumë duke rënduar besimin e aplikuesve.

b. Lehtësimi i numrit të procedurave në aplikime veçanërisht për fermerët

Fermerët e shikojnë si akoma të vështirë vetë procesin e aplikimit dhe plotësimin e shumë dokumentave duke kaluar nga një institucion tek tjetri. Kriteret tilla si dëshmi penaliteti, ekstrakti i regjistrimit nga QKR, lejet e ndërtimit në rastin e mbështetjes për investime, apo vërtetimin nga OSHEE, vërtetimin e fermerit apo regjistrin e fermës, vërtetime për sigurime shoqërore, etj., mund të shmangen edhe me verifikimet direkte **online** nga institucionet ndërmjet njëri – tjetrit apo aksesin në bazën e tyre të të dhënave, për t'i lënë mundësi fermerit të përqendrohet në hartimin e planit të biznesit apo marrjes së lejeve të ndërtimit dhe certifikatës së pronësisë. Ndërkohë që shpenzimet e kryera dhe koha e harxhuar për fermerin për të përgatitur dosjen e aplikimit janë të njëjta pavarësisht vlerës së

mbështetjes së kërkuar. Afati i aplikimit prej 30 ditë për skemat mbështetëse sidomos për ato në investime shikohet i kufizuar për shkak të burokracive të përmendura.

3. TË TJERA

d. Parcelizimi i tokës bujqësore - problem për investime të qëndrueshme

Sipas INSTAT për vitin 2014 është vënë re një rritje e numrit të fermave me 0,4% krahasuar me një vit më parë, e shoqëruar kjo me rënie të madhësisë mesatare të fermës me 0,6%²⁴. Toka bujqësore ku kryen aktivitetin e saj një familje fermere në Shqipëri është e kufizuar me një mesatare prej 1,16 ha aktualisht. Jo vetëm madhësia, por edhe copëtimi i saj në disa parcela (mesatarisht 3-4) për çdo ekonomi bujqësore përbën një pengesë thelbësore për zhvillimin e ekonomisë së shkallës dhe konkurrueshmërinë në tregjet rajonale e evropiane.

e. Mungesa e titujve të pronësisë së tokës dhe dinamika e reformës së pushtetit lokal

Regjistrimi zyrtar i tokës bujqësore dhe mungesa e titujve të pronësisë (certifikata e tokës) përbën një nga problematikat e lidhura me informalitetin, zhvillimin e tregut të tokës, mungesën e investimeve dhe aplikimit të skemave mbështetëse aktuale dhe ato që pritet të realizohen përmes programit BE/IPARD dhe AZHBR²⁵. Fermerët raportojnë për vështirësi në pajijen me certifikata pronësie pasi ka shumë pasaktësi ndërmjet hartave kadastrale dhe situatës faktike të ndarjes

²⁴ Burimi: INSTAT: Statistikat e Bujqësisë dhe Blegtorisë për vitin 2014. Njoftim për mediat Tiranë (22 qershor 2015);

²⁵ Një nga kriteret kryesore të skemave mbështetëse për fermerët është që fermerët aplikues duhet të jenë të pajisur me certifikatë pronësie të tokës bujqësore.

dhe përdorimit të tokës. Me ndarjen e re territoriale, bashkitë janë ngarkuar të kryejnë përgatitjen e plan-vendosjeve të tokës bujqësore dhe orientimin në praktikë të fermerëve lidhur me regjistrimin e tokës bujqësore. Në këtë aspekt evidentohen përpjekje nga ana e tyre për të ndërgjegjësuar komunitetet rurale për t'u pajisur me certifikatat e pronësisë për tokën bujqësore, duke aplikuar pranë bashkive me dokumentacionin përkatës. Procedura administrative dhe e koordinimit institucional do të mbulohet nga bashkitë në bashkëpunim me Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP). Përmbyllja e këtij procesi sigurisht që kërkon kohë.

f. Afatet dhe specifikat e lejeve të ndërtimit në bujqësi

Marrja e lejeve të ndërtimit dhe procedurat përkatëse janë konsideruar si problematike dhe pengesë për investime të qëndrueshme në bujqësi, veçanërisht sa i përket thithjes së granteve të huaja. Ndër kërkesat për aplikim në skemat mbështetëse është edhe leja e ndërtimit të objekteve, stalla, pika përpunimi, magazina, dhoma frigoriferike, etj. Referuar legjislacionit shqiptar në fushën e ndërtimit²⁶ procedurat janë të unifikuara si për objekte banimi dhe objekte industriale. Megjithatë, zhblllokimi së fundmi i lejeve të ndërtimit pranë bashkive me anë të miratimit të VKM nr. 271 datë 06.04.2016 e cila ka për qëllim krijimin, vënien në funksionim dhe përdorimin e Sistemit Elektronik të Lejeve²⁷, përmes të cilit do të realizohen elektronikisht procedurat e aplikimit për leje, si dhe procedurat e shqyrtimit dhe

miratimit të këtyre kërkesave, përbën një hap pozitiv. Në të vërtetë i gjithë legjislacioni i adoptuar dhe që është aktualisht në fuqi në fushën e zhvillimit dhe planifikimit të territorit, duke parashikuar afate të qarta dhe parimin e miratimit në *heshtje*²⁸ nga ana e Bashkive, pritet të krijojë mundësi të reja dhe thjeshtimin e burokracive të deritanishme edhe përsa i përket sferës së ndërtimeve që lidhen me bujqësinë.

g. Cënimi i sigorisë ushqimore për konsumatorin – p.sh. cilësia e dobët e inputeve bujqësore

Formalizimi i sektorit të bujqësisë i realizuar në të gjithë zinxhirin e aktorëve të përfshirë që nga furnizuesit me inpute, prodhuesit, grumbulluesit, përpunuesit, tregtarët, etj., sjell edhe premisa për rritjen e cilësisë dhe standardeve përmes mundësisë që krijohet për gjurmueshmëri të prodhimit. Nga informacioni i grumbulluar në terren *rezulton se janë serioze problematikat që lidhen me cilësinë e inputeve bujqësore sidomos medikamenteve, plehrave, preparateve kimike, ushqimeve blegtorale, farërave, fidanëve, etj. Në shumë raste farmacistë bujqësore tregtojnë me çmime abuzuese shumë të larta, tregtojnë produkte të pakontrolluara, si dhe në mungesë të dorëzimit të kuponit apo faturës tatimore tek blerësi (fermeri). Nga ana e tij fermeri duke qenë se nuk përgatit në shitje faturë tatimore, shfaq pak interes për t'u pajisur me faturë të tillë apo kupon tatimor kur blen inpute ose shërbime. Mjafton të sjellim këtu në vëmendje problematikën kritike të ngritur mbi industrinë e përpunimit të qumështit ku një pjesë e mirë e*

²⁸ Sipas Nenit 44.3 të Ligjit Nr. 107/2014 leja e ndërtimit konsiderohet e miratuar në heshtje nëse autoriteti përgjegjës (Bashkia) nuk merr vendim brenda afatit 60 ditë nga dita e aplikimit dhe struktura përgjegjëse e planifikimit pranë autoritetit vendor nuk ka dhënë mendim negativ lidhur me kërkesën.

²⁶ Ligji Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", VKM Nr. 408 datë 13.05.2015 dhe VKM Nr.271 datë 06.04.2016 dhe VKM Nr.283 datë 1.4.2015;

²⁷ Duke filluar prej datës 01 shtator 2016 çdo aplikim për leje ndërtimi do të bëhet nëpërmjet portalit elektronik;

baxhove janë informale dhe jashtë kontrollit të institucioneve publike. Ndaj, ndjekja e procedurave të formalizuara në shit-blerje në të gjitha hallkat e saj, bëhet një kusht për të garantuar një produkt të sigurtë e cilësor tek përdoruesi fundor – konsumatori.

Fermerët shprehin shqetësim se nuk kanë informacion mbi iniciativat dhe programet e qeverisë në mbështetje të tyre, por edhe nuk gjejnë përkrahje në lidhje me cilësinë e farave, pesticideve, kulturave që duhet të mbjellin, si dhe mbështetje me këshillime gjatë ecures së zhvillimit të aktivitetit. Referuar anketës së FIAA dhe Unionit Shqiptar Kursim – Kredit (2014)²⁹ rreth 90% e fermerëve nuk kryejnë rregullisht analizat e tokës bujqësore. Gjithashtu, ndërgjegjësimi i tyre ndaj kontributit fiskal dhe mbajtjes së llogarive financiare mbetet shumë i ulët duke krijuar edhe vështirësi në hartimin e planeve të biznesit dhe aplikimit për financim.

h. Paqartësi mbi funksionin, rolin dhe interpretimin lidhur me SHBB-të

Nga diskutimet me fokus grupet rezulton se ligji mbi SHBB është i pa qartë për fermerët, sikurse dhe interpretimet që bëhen mbi ligjin janë subjektive. Ndërkohë në praktikë SHBB nuk kanë asnjë avantazh nga një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK), megjithëse ligji parashikon

incentiva fiskale të cilat do të qartësoheshin me aktet nënligjore, të cilat akoma mungojnë. Kështu në Sarandë raportohet të jenë krijuar SHBB-të e para në sektorët bujqësi, blegtori, pyje, kullota, etj., por si rezultat i paqartësive të ligjit, ato kanë pushuar së ekzistuari dhe kanë probleme me detyrime të lindura pranë organeve tatimore.

i. Statistika jo të qarta mbi regjistrin e fermerit dhe aktivitetin bujqësor në vend

Nga takimet e zhvilluara me institucionet publike dhe ekspertët e bujqësisë nënvizohet mungesa e të dhënave të plota dhe të unifikuara lidhur me sektorin e bujqësisë. Të dhënat e INSTAT paraqesin të dhëna administrative të MBZHRAU, ndërkohë që nuk janë publikuar ende rezultate të vrojtimeve statistikore në terren. Nuk është e qartë nëse fermeri identifikohet me fermën sipas përkufizimit të këtyre të fundit në Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”³⁰. Gjithashtu, nga takimet e zhvilluara nga SKI është konstatuar se ende nuk ka një regjistër të konsoliduar të fermës që t’i përgjigjet kartës së fermerit apo NIPT-it që monitoron aktivitetin e tij ekonomik, prodhues, sipërfaqen e tokës të shfrytëzuar, duke vënë kështu në diskutim të dhënat në lidhje me sektorin.

³⁰ “Fermë” është njësi ekonomike bazë në bujqësi dhe në veprimtaritë ekonomike që lidhen të. Është një sipërfaqe toke apo veprimtari që kryesisht i kushtohet prodhimit dhe menaxhimit të ushqimit ose prodhimit blegtoral.

²⁹ FIAA, ASC Union “Albanian Agriculture seen from the everyday farming: A Survey on Albanian farmers and EU exports” support by EU, July 2014

REKOMANDIMET

REKOMANDIM 1.

PËR NJË REFORMË FORMALIZIMI PËR NXITJEN E INVESTIMEVE DHE RRIJTJEN E SIGURISË USHQIMORE

- 01. Ngritja e një grupi pune (task force me aktorë publik, privat, ekspertë) për studimin dhe analizën e thelluar të problematikës së formalizimit dhe funksionimit të skemës së TVSH-së në një zonë pilot me aktivitet intensiv bujqësor (p.sh. aty ku numri i fermerëve të regjistruar është më i madh), proces i cili duhet shoqëruar me analizën e impaktit ekonomik e social.* Rezultatet e analizës duhet të dokumentohen në një plan të qartë masash të shtrira në kohë dhe të koordinuara midis aktorëve kryesorë të përfshirë në proces, duke e konsideruar formalizimin si proces të domosdoshëm dhe pa kthim prapa.
- 02. Saktësimi i të dhënave të qarta, unike mbi fermerin dhe regjistrin e tij, si edhe vizioni mbi hapat që do ndiqen nga autoritetet më tej si p.sh. nëse do të ketë lidhje midis NIPT-it dhe parcelës, etj.* Nga takimet e zhvilluara me institucionet publike dhe ekspertët e bujqësisë nënvizohet nevoja urgjente e zgjidhjes së këtij

problemi. Progres raporti i BE-së (2015)³¹ ka vënë theksin në përgatitjen sa më të shpejtë të regjistrimit të fermës mbi bazën e të cilit do të identifikoheshin fermat dhe numri real i fermerëve, ende nuk ka një rezultat konkret dhe përfundimtar mbi adresimin e kësaj problematike.

- 03. Përgatitja e moduleve dhe zbatimi i tyre në praktikë, përmes të cilave regjistrimi i fermerit dhe fermës të lidhen me NIPT-in dhe një sistem efikas të rimbursimit të TVSH-së.*
- 04. Rekomandohet ngritja e një sporteli (platforme) informacioni dhe asistence të veçantë për sektorin e bujqësisë ku të mundësohet ofrimi i asistencës fiskale dhe edukimi financiar.* Më vonë edhe mund të përdoret për të eliminuar përdorimin e dokumentacionit letër që kërkohet nga bankat për efekt financimi.
- 05. Formalizimi të lidhet ngushtë me gjurmueshmërinë e produkteve dhe sigurinë ushqimore, ku një rëndësi e veçantë t’i kushtohet përgatitjes së kartave teknologjike.* Ky rekomandim, duhet të shihet ngushtë me rekomandimet e Këshillit të Investimeve (dhjetor

³¹ Ky rekomandim është i artikuluar edhe nga institucione të tjera publike dhe private.

2015), ku problematika është trajtuar më specifikisht për sektorin e qumështit.

06. Pronësia ngelet një ngërç për investime më produktive dhe në sipërfaqe të mëdha në bujqësi, ndaj duhet konsideruar prioritet përparimi në këtë proces nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Bashkitë dhe Ministria e Bujqësisë. Megjithëse ka filluar ndërgjegjësimi për fermerët për t'iu drejtuar bashkive për regjistrimin e tokës, sërish ka pengesa në burimet e alokuara nga bashkitë në këtë proces, por edhe paqartësi në përputhjen e hartave me realitetin në terren.
07. Njësitë e qeverisjes vendore në kuadër të përgjegjësiave të reja dhe shtrirjes më të gjerë territoriale të marrin masa për krijimin e tregjeve të posaçme për fermerët për të promovuar produktet karakteristike të zonave të tyre por edhe për të mundësuar kontroll në produktet e tregtuara. Rekomandohet që të krijohen modele pilot në disa bashki, siç po tenton aktualisht Bashkia e Tiranës. Hapja e disa tregjeve paralele në pika të ndryshme të njësisë vendore do të shmangë edhe situatat oligopol që krijojnë tregjet e shumicës dhe disa tregtarë ndaj fermerëve.

REKOMANDIM 2.

TË TJERA - LEHTËSIM TË PROCESIT TË FORMALIZIMIT

01. Të mundësohet në një periudhë të afërt, verifikimi online i vërtetimeve për fermerin nga drejtoritë rajonale të bujqësisë. Qartësim dhe ndërgjegjësim mbi NIPT-in. Të lehtësohet fermeri nga marrja e vërtetimit si fermer në drejtoritë rajonale të bujqësisë, ndërsa verifikimi të bëhet ndërmjet institucioneve mundësisht elektronikisht. Gjithashtu, dre-

jtoritë rajonale tatimore, drejtoritë rajonale të bujqësisë dhe shoqatat e agro-industrisë duhet të intensifikojnë fushatat e informimit dhe sqarimit mbi NIPT-in e fermerit, për çfarë shërben dhe si duhet të funksionojë.

02. Të vlerësohet rritja e subvencioneve në prodhim dhe lehtësimi i procedurave për këtë skemë. Në takimet e zhvilluara me fermerë është vlerësuar nga ata skema e subvencionit mbi bazën e faturave të shitjeve të sasive të prodhuara si një masë shumë e mirë nxitëse për formalizim. Ndaj rekomandohet që të shikohet shtrirja në një fashë të caktuar në bazë të prodhimit për një grup më të gjerë fermerësh si një incentivë direkte formalizimi p.sh. të thjeshtohen kërkesat për këtë skemë me paraqitjen e auto-faturës në shitje të grumbulluesit/përpunuesit.
03. Asistencë në thjeshtimin e procedurave të aplikimit në skemat e subvencionimit, p.sh. kërkesa të tilla si dëshmia e penalitetit, ekstrakti i QKR, apo vërtetim për pagesën e detyrimeve ndaj OSHEE, sigurime shoqërore, detyrime taksash mund të verifikohen nga vetë AZH-BR për aplikantët fitues, për të lehtësuar ecejaket e fermerëve nëpër institucione.
04. Për efekt të karakterit sezonal mund të konsiderohet rritja e tavanit të pagesave me para në dorë përtej 30.000 ALL. Kërkesa ka ardhur në vëmendje të Sekretariatit nga fermerë dhe grumbullues në pamundësi për të patur akses në shërbimet financiare dhe në përgjigje të natyrës sezonale të punës së tyre. Sugjerohet që kjo çështje të rishikohet me kalimin e një afati të arsyeshëm 1 - 2 vjet, me qëllim që të verifikohet efikasiteti i tavanit aktual.
05. Të lehtësohet mënyra e zbatimit të skemës për fermerët dhe grumbulluesit. Blerësi (grumbulluesi) i prodhimeve bujqësore të mos ketë më

detyrimin që të njoftojë paraprakisht në organet tatimore akt-marrëveshjen midis palëve. Duke patur parasysh se procesi i shit-blerjes në zonat rurale është një proces ende i pakonsoliduar, ku marrëdhëniet midis fermerit dhe grumbulluesit kanë ende një natyrë rastësore, zbatimi i dispozitës sikurse është parashikuar aktualisht është i vështirë dhe jo realist. Rekomandohet që akt-marrëveshja midis palëve (blerësit të prodhimeve bujqësore të fermerit, personi i tatueshëm dhe fermerit) të përgatitet dhe printohet në momentin e kryerjes reale të shit-blerjes midis palëve dhe në momentin e plotësimit të auto-faturës nga ana grumbulluesit.

06. Evidentim të tregjeve informalë dhe pikave informale të grumbullimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, të cilat bëjnë konkurrencë të pandershme dhe shmangen nga standardet ligjore. Koordinim ndërmjet AKU, Drejtorisë së Tatimeve dhe Bashkive është i domosdoshëm për të shmangur informalitetin në tregtimin e produkteve bujqësore dhe bleg-

torale të pakontrolluara. Referuar rekomandimeve të marra nga takimet informaliteti në agro-industri formalizimi duhet të fillojë nga produkti fundor, pra nga tregu i pakicës dhe shumicës për të ndjekur të gjithë zinxhirin e vlerës. Problematikë madhore mbetet sektori i qumështit dhe nënprodukteve e tij si dhe tregtimi i mishit dhe nënproduktet e tij.

07. Informacion/Ndërgjegjësim për fermerët nga pushteti qëndror në koordinim me pushtetin vendor. Është e domosdoshme një fushatë e vazhdueshme informimi dhe ndërgjegjësimi mbi nismat e qeverisë por edhe mbi kulturat bujqësore dhe inputet e nevojshme për të përmirësuar cilësinë e produkteve bujqësore sipas standarteve të tregut ndërkombëtar. Sërish, drejtoritë rajonale të bujqësisë kanë rol të rëndësishëm ndaj është e domosdoshme përcaktimi i qartë i hierarkisë vertikale të tyre midis pushtetit qëndror dhe lokal. Ndërkohë që kërkohet që ekspertët e bujqësisë të jenë më në terren dhe afër fermerit për t'i asistuar dhe drejtuar gjatë procesit të prodhimit.

SHTOJCA 1

Skema e kompensimit të TVSH-së

1. SUBJEKTET E SKEMËS

01. Skema e kompensimit zbatohet për prodhuesit bujqësorë sipas një liste të përcaktuar të aktiviteteve prodhuese bujqësore, të cilët nuk i nënshtrohen regjimit normal të TVSH-së për arsye se aplikimi i regjimit normal të TVSH-së krijon vështirësi administrative. Nga skema nuk mund të përfitojnë:

- fermerët që furnizojnë (shesin) produktet e tyre bujqësore sipas këtij regjimi, qarkullimi vjetor i të cilit është mbi kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në prej 5.000.000 ALL të cilët detyrimisht duhet të regjistrohen si tatimpagues për përgjegjësinë tatimore me TVSH, si edhe;
- fermerët të cilët edhe pse janë pjesë e skemës së kompensimit (xhiro deri në 5.000.000 ALL), vullnetarisht zgjedhin t'i nënshtrohen regjimit normal të TVSH-së, duke iu nënshtuar kësisoj çdo të drejte dhe detyrimi për regjistrim, deklarim, llogaritje dhe pagesë të TVSH-së sipas përcaktimeve ligjore.

02. Udhëzimi e vendos barrën administrative mbi *“grumbulluesit”* të cilët shërbejnë si “agjentë” për zbatimin në praktikë të skemës dhe pagimin e TVSH-së fermerëve dhe më pas për të kryer procedurat e aplikimit pranë organeve tatimore për kompensimin e TVSH-së. Konkretisht sipas Udhëzimit çdo blerës (grumbullues) i produkteve të fermerit që aplikon skemën e kompensimit, duhet të njoftojë drejtorinë rajonale tatimore përkatëse që është aplikues i skemës së kompensimit të fermerit përpara se të fillojë aplikimin e saj, duke e shoqëruar njoftimin me një akt marrëveshje midis palëve (blerësit të produkteve të fermerit, person i tatueshëm dhe fermerit), sipas modelit të aktmarrëveshjes bashkëngjitur udhëzimit. Për çdo marrëveshje shtesë me një fermer të ri që blerësi person i tatueshëm hyn në transaksione duhet të njoftojë drejtorinë rajonale tatimore përkatëse. Mosnjoftimi në kohë dhe mos-aplikimi korrekt sipas kësaj procedure i heq blerësit të drejtën e zbritjes së TVSH-së si normë e kompensimit të shënuar në faturën e lëshuar në emër të fermerit, marrëveshja me të cilin nuk i është dërguar (njoftuar) organit tatimor.

2. PROCEDURA E PAJISJES ME NIPT SIPAS SKEMËS SË KOMPENSIMIT TË TVSH-SË

Regjistrimi i fermerit bëhet pranë drejtorisë rajonale tatimore. Dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga fermeri është si më poshtë:

- Aplikimi për regjistrim sipas formularit përkatës i cili duhet të përmbajë këto të dhëna:
 - Të dhënat e identifikimit të fermerit, adresa e banimit, kontakte të personit;
 - Vendi i ushtrimit të veprimtarisë prodhuese bujqësore;
 - Fusha e veprimtarisë prodhuese bujqësore;
- Dokumenti origjinal i identifikimit ose kopje e noterizuar i cili i bashkëngjitet aplikimit për regjistrim;
- Vërtetimin origjinal sipas një formati të përcaktuar nga vetë Udhëzimi i lëshuar për fermerin nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në bazë të të cilit vërtetohet aktiviteti prodhues bujqësor i fermerit.

Drejtoria Rajonale Tatimore, pasi kryen verifikimet përkatëse dhe vëren përmbushjen e kushteve për regjistrim, kryen regjistrimin e fermerit në regjistrin tatimor. Sipas Udhëzimit, certifikata e regjistrimit duhet të lëshohet brenda një afati prej 2 ditësh nga data e paraqitjes së aplikimit.

3. TRANSAKSIONET FERMER - GRUMBULLUES

Nga transaksionet bankare, në transaksione sipas fushave të ndryshme.

Lejimi i kryerjes së shitjeve me para në dorë, deri në vlerën 30,000 ALL, që një fermer kryen për blerës të ndryshëm, shoqëri të agro-biznesit ose të përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, ose për eksportuesit e këtyre produkteve, apo çdo subjekti tjetër që blen produktet e fermerëve që janë të pajisur me NIPT. Transaksionet fermer-blerës nga 30.000 ALL deri në 150.000 ALL kryhen nëpërmjet filialeve të postës shqiptare. Ndërsa transaksionet fermer-blerës për vlera më të mëdha se 150.000 ALL detyrohen të kryhen nëpërmjet bankës.

SHTOJCA 2

Analiza e aktorëve të nënsektorit të perimeve

Perimet përbëjnë një nga nën sektorët më produktivë dhe të rëndësishëm të bujqësisë Shqiptare, me mundësi të mira të rritjes së tregut të brendshëm dhe atij për eksport. Aktualisht, të dhënat tregojnë një tendencë në rritje në këtë nën sektor, duke marrë parasysh se në vitin 2000 prodhimi i perimeve në fushë ka qënë 620.000 ton, në vitin 2014 ky prodhim shënon 950.000 ton. Veçanërisht kultivimi i perimeve në sera ka tërhequr vëmendjen e fermerëve si një aktivitet fitimprurës dhe me tregje më të sigurta kryesisht eksporti, gjë që ka sjellë jo vetëm rritjen e sipërfaqes së serave


(nga 462 ha në vitin 2000 në 1.085 ha në vitin 2014), por edhe rritjen e prodhimit në sera me 2,4 herë gjatë së njëjtës periudhë.

Perimet po shihen gjithnjë e më shumë si një burim i mirë i gjenerimit të të ardhurave për ekonominë, duke konsideruar peshën e tyre në rritje në eksportet shqiptare, pasi vlera e perimeve të eksportuara është rritur dy here vetëm nga viti 2014 në vitin 2015, respektivisht nga 2.282 milion ALL në 4.112 milion ALL.

Aktorët që kontribuojnë në këtë sektor dhe veprimtaria e tyre nga këndvështrimi i formalizimit të ekonomisë bujqësore jepen në diagramën e mëposhtme.

PËR FORMALIZIMIN NË BUJQËSI:
MIRËFUNKSIONIMI I SKEMËS
SË KOMPENSIMIT TË TVSH-SË
DHE NXITJA E INVESTIMEVE

Diagrama e subjekteve në sektor



FERMERËT E VEGJËL - TRADICIONALË

Ato përbëjnë thelbin e prodhuesve të këtij sektori sa i përket numrit, me rreth 80% të numrit total të prodhuesve. Prodhimi i tyre bazohet në operacionet e realizuara nga familja në një sipërfaqe që varion nga 0,9 në 1,2 ha. Kjo kategori prodhon si për konsum të vetë familjes ashtu edhe për tregtim. Në treg përgjithësisht ata futen ose në mënyrë direkte individualisht kryesisht në tregjet e rrugës ose përmes tregtarëve. Njëkohësisht ky segment prodhuesish është blerës i inputeve bujqësore si farëra, fidanë, plehra, pesticide, herbicide, etj. Ata përbëjnë grupin kryesor të fermerëve prodhues të pa formalizuar si në shitje të produkteve ashtu edhe në blerjen e inputeve.

FERMERËT E MËDHENJ TRADICIONALË, KRYESISHT KULTIVUES NË FUSHË TË HAPUR

Kjo kategori është pjesë e fermave të mëdha që variojnë nga 2 në 25 ha, që janë kryesisht të pozicionuara në zonën e ulët të vendit kryesisht në Fier, Lushnjë, Berat, Shkodër, etj. Ato janë të përfshirë në mënyrë tipike në prodhimin e bimëve

një vjeçare me një shkallë të mirë rikthimi të investimit dhe kultivojnë kryesisht shalqi, lulelakër, karrota, brokoli, domate, kastraceva dhe patate. Tregu i tyre kryesor i shitjes është tregu i shumicës që në masën më të madhe realizon blerje me auto-faturim. Ndërsa furnizimin me fidanë, plehra, pesticide, insekticide, etj., ata e realizojnë përmes tregtarëve të inputeve, por qëndrojnë indiferentë ndaj blerjeve të shoqëruara me faturë tatimore. Kjo kategori fermerësh kryen operacione në fermë në varësi të madhësisë së fermës dhe proceseve të përfshira, me angazhimin e anëtarëve të familjes dhe/ose të punësuarve kryesisht me kohë të pjesshme. Ata operojnë kryesisht me mjetet e tyre mekanike, ose marrin shërbime nga mekanizatorë të specializuar me pagesë që në të shumtën e rasteve nuk ofrojnë shërbim të formalizuar.

FERMERËT E MËDHENJ E MODERN, KRYESISHT ME AKTIVITET NË SERA

Ky grup përbëhet kryesisht nga fermerë që kultivojnë perime në sera. Gjatë pesë viteve të fundit, me rritjen e volumit të eksporteve, numri i

fermerëve që merren me kultivimin e perimeve si dhe sipërfaqja e tyre respektive e kultivimit në sera janë rritur në mënyrë të ndjeshme. Ata janë përdorues të teknologjive intensive të kultivimit me një përdorim të konsiderueshëm të plehrave, kimikateve, fuqisë punëtore, shërbimeve të mekanizuara, etj., kjo edhe në varësi të sipërfaqes së kultivuar. Kjo kategori fermerësh i shet prodhimet kryesisht tek tregtarët e shumicës si dhe konsoliduesit/shpërndarësit me destinacion për eksport, tregun e brendshëm për konsum dhe për përpunim. Përfaqësojnë kategorinë kryesore të fermerëve prodhues të sektorit të formalizuar (pajisur me numër NIPT-i), por njëkohësisht janë pjesë e auto-faturimeve nga grumbulluesit, dhe në disa raste janë pjesë e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në skemën e TVSH-së. Këta të fundit shfaqin interes në pajisjen me fatura tatimore në blerjen e inputeve apo shërbimeve për aktivitetin që kryejnë.

GRUMBULLUESIT/KONSOLIDUESIT

Konsoliduesit janë tregtarë (ose blerës nga vendet e rajonit, ose blerës shqiptarë) të cilët i grumbullojnë produktet direkt nga fermerët me të cilët ata kanë kontrata të rregullta për perime të freskëta duke eksportuar brenda rajonit ose në tregjet evropiane apo më gjerë. Ky sistem iu ofron kultivuesve një shkallë sigurie mbi tregun dhe shërben si një forcë orientuese për kultivuesit me qëllim planifikimin e prodhimit të tyre. Ata përdorin të dy burimet për grumbullim, ose direkt përmes fermës, ose përmes qendrave të grumbullimit në fshat. Qendrat e grumbullimit po bëhen gjithnjë e më shumë të rëndësishme; disa prej tyre janë mbështetur nga skemat shtetërore, ose nga skemat e programit të BE/IPARD Like, duke përmirësuar kështu gjurmueshmërinë si dhe standardet e

prodhimit përmes gradimit, përzgjedhjes dhe paketimit të duhur të produkteve. Ato shërbejnë si forcë lëvizëse jo vetëm sa i përket volumit që grumbullojnë, por gjithashtu edhe në procesin e formalizimit të ekonomisë bujqësore. Ndaj, si fermerët ashtu edhe tregtarët i shohin pikat e grumbullimit si një faktor i rëndësishëm në të gjithë zinxhirin e vlerës. Marrëdhënia e tyre me shitësin (fermerin) është bazuar në autofaturim. Gjithsesi, kjo kategori është e vendosur nën presionin e konkurrencës së pandershme nga grumbullues të pidentifikuar.

PËRPUNUESIT

Shumica e firmave përpunuese operojnë me lëndë të parë si perime ashtu edhe fruta. Megjithëse ndërmarrje të tilla janë të përhapura kudo, pjesa më e madhe e tyre gjendet kryesisht në zonat ku është i përqendruar prodhimi si dhe aty ku ekziston tradita e eksperiencës, zona të tilla si Shkodra, Lezha, Dibra, Berati, Lushnja, Kavaja, Fieri, Gjirokastra, Përmeti, Tirana, Elbasani, Durrësi. Krahas ndërmarrjeve të mëdha të përpunimit, ekziston dhe një segment përpunimi informal në kushtet e punishteve të vogla apo në kushtet e shtëpisë dhe që përbën bazën e informalitetit të këtij segmenti, duke gjeneruar njëkohësisht problematika edhe me sigurinë ushqimore e konkurrencën e pandershme. Përpunuesit e formalizuar në masën më të madhe e blejnë lëndën e parë drejtpërsëdrejti nga fermerët e mëdhenj shqiptarë, ndërsa pjesa tjetër blihet nga tregjet e shumicës ose importohet nga vendet e rajonit. Të gjitha këto burime varen nga volumi i prodhimeve si dhe çmimet e tyre. Zakonisht përpunuesit kanë kontrata me grumbulluesit/konsoliduesit, që nga ana e tyre kanë kontrata me prodhuesit kryesisht ata të vegjël për të prodhuar produkte specifike sipas kërkesës së

PËR FORMALIZIMIN NË BUJQËSI:
MIRËFUNKSIONIMI I SKEMËS
SË KOMPENSIMIT TË TVSH-SË
DHE NXITJA E INVESTIMEVE

përpunuesve dhe rrallë me prodhues të mëdhenj të cilët janë të prirur kryesisht drejt produkteve me vlerë të lartë.

SHITËSIT ME SHUMICË

Tregjet e shumicës janë zhvilluar në zonat më kryesore të prodhimit të tilla si Lushnja, Vlora, Shkodra, Berati, Tirana dhe Korça. Këto janë tregje aktive me aktivitet gjithëvjeter duke operuar me volume të mëdha paketimi si arka 20-25 kg. Zakonisht shitësit e shumicës kanë një apo disa mjete me kapacitet 7-10 ton dhe janë transportuesit kryesor të produkteve në të gjithë Shqipërinë. Burimi i furnizimit të tyre janë të gjitha kategoritë e fermerëve, ndërsa tregu i tyre kryesor është ai i brendshëm me shumicë. Marrëdhënia e tyre kryesisht ngrihet mbi bazën e auto-faturimit që pasqyrohet edhe në dokumentacionin e mjetit transportues.

SHITËSIT ME PAKICË

Përfaqëson një treg shumë të fragmentuar prej disa qindra mijëra dyqane të vegjël që kryesisht furnizohen nga shitësit e shumicës që operojnë në nivel rajonal. Krahas këtij kanali furnizues, tregjet e pakicës tregtojnë edhe produktet e tyre. Pjesë e këtyre tregjeve të pakicës nuk janë vetëm dyqanet e vegjël ose tregjet e hapura, por gjithashtu edhe supermarketet që në disa raste kanë krijuar zinxhirin e tyre në disa zona të Shqipërisë të tillë si Conad, Big Market, TEG, Carrefour, etj., ku këta të fundit përfaqësojnë grupimin më të formalizuar të këtij segmenti.

EKSPORTUESIT

Eksportet e perimeve kryesisht bazohen tek grumbulluesit/konsoliduesit, gjithsesi tregje të tilla janë ende të paqëndrueshme dhe jo sistematike për arsye të ndryshme të tilla si koha dhe

volumi i shitjeve, cilësia e produkteve, pesha uniforme, madhësia e paketimit, materiali i paketimit, modeli i tij, gjurmueshmëria, certifikimi, ruajtja dhe mbajtja në gjendje të freskët. Gjithsesi eksporti konsiderohet si një forcë drejtuese për prodhimin, për një çmim më të mirë, përmbushjen e aspekteve sociale (punësimi) si dhe formalizimin e ekonomive bujqësore. Është segmenti që operon me vetë-faturime në marrëdhëniet me prodhuesin, dhe shoqëron mallin në shitje me faturë tatimore subjekt i verifikimeve edhe nga dogana shqiptare.

FURNIZUESIT ME INPUTE DHE OFRUESIT E SHËRBIMEVE

Pjesa kryesore e bazës materiale që përdoret për prodhimin e perimeve (krahas kapitalit kryesor si toka, sera, mekanizimi) përfshin plasmasin, farërat dhe/ose fidanët, plehërat kimike, herbicidet, pesticidet, veglat e punës, etj. Në shumë raste, veçanërisht në fermat e mëdha, janë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me tregtarët ose me konsoliduesit, të cilët në disa raste janë prodhues të fidanëve. Më tej furnizimi me fidanë “shlyhet” nga fermerët përmes prodhimit që fermeri i jep tregtarit/konsoliduesit/grumbulluesit. Ndërsa në rastin e produkteve të tjera të tillë si plehu kimik, herbicidet, pesticidet, fermerët furnizohen nga farmacitë bujqësore. Aktualisht nën Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, ka hyrë në fuqi rregullorja për veprimtarinë e këtyre farmacive. Fermerët mund të blejnë inpute vetëm në farmaci bujqësore të licencuara dhe mbi bazën e recetave të lëshuara nga specialistët e licencuar, por në realitet kjo skemë rrallë aplikohet. Fermeri në pak raste pajiset me kasë fiskale apo faturë tatimore për inputet që blen, apo shërbimet që merr siç është mekanizimi i operacioneve.

RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomike
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council